

Syllabusi i lëndës: Modeli i Syllabusit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë
Titulli i lëndës:	Parandalimi dhe shëndeti mental në shkollë
Niveli:	Master
Statusilëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Për t'u definuar
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Dashamir Bërxulli
Detajet kontaktuese:	dashamir.berxulli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Lënda ofron një tablo të koncepteve të parandalimit në lidhje me shëndetin mental në mjedisin e shkollës. Ajo synon të ofrojë informacion relevant për teorinë, praktikën dhe shkencën e parandalimit, duke i vënë në kontekst të problemeve në shkollë. Lënda do të ofrojë raste studimi nga literatura dhe praktika. Gjatë lëndës, studentët do të bëjnë analiza dhe kritika, duke zhvilluar pikëpamje individuale mbi praktikën parandaluese dhe iniciativat për politikën publike në raport me shkollën dhe dinamikat përkatëse.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës 'Parandalimi dhe shëndeti mental në shkollë' është konsolidimi i një qasjeje filozofike proaktive parandaluese për problemet e shëndetit mental në shkollë të studentët e drejtimit 'Psikologji shkollore & këshillimi'.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Njohja e historisë së parandalimit në katër dekadat e fundit; • Përkufizimi i parandalimit në mjedisin shkollor; • Ofrimi i modeleve të parandalimit relevante për mjedisin shkollor; • Qartësimi i lidhjes së këshillimit me parandalimin; • Njohja dhe diskutimi i vlerësimit e dizajneve parandaluese.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			3
Ushtrime në terren			
Kolokiume,seminare	2	5	10
Detyra shtëpie			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim			12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			2
Projektet,prezentimet ,etj			8
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërime 50%; Diskutim me studentët 20%; Diskutimet e studentëve mes vete 15% Konsultime mbi lëndën dhe mbi punimin seminarik 15% Përqindjet e dhëna më sipër janë të synuara dhe të përafërta; varësisht nga prirjet e studentëve dhe nga perceptimi i mësimdhënësit mbi mundësitë për të bërë një punë optimale, këto përqindje mund të pësojnë ndryshime të lehta.		
Metodat e vlerësimit:	Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 10% Punimi seminarik: 30% Provimi final: 60%		
Literatura			
Literatura bazë:	Adelman, H., Taylor, L. (2009). <i>Mental health in Schools: Engaging learners, preventing problems and improving schools.</i> Sage Publications. ISBN: 1412975387, 9781412975384 Albee, G.W. & Gullotta, T.P. (Eds.) (1997). <i>Primary prevention works.</i> Thousand Oaks, CA.: Sage Publications.		
Literatura shtesë:	Artikuj të përzgjedhur nga profesori i lëndës		

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në lëndë
<i>Java e dytë:</i>	Qasje teorike mbi shëndetin mental
<i>Java e tretë:</i>	Shkenca e parandalimit: Një shikim historik dhe i zhvillimeve aktuale
<i>Java e katërt:</i>	Shëndeti mental në shkollë
<i>Java e pestë:</i>	Programet parandaluese: dizajni, implementimi dhe vlerësimi
<i>Java e gjashtë:</i>	Praktikat më të mira: Parandalimi i stresit
<i>Java e shtatë:</i>	Praktikat më të mira: Parandalimi i depresionit
<i>Java e tetë:</i>	Praktikat më të mira: Parandalimi i përdorimit dhe abuzimit të substancave psikoaktive
<i>Java e nëntë:</i>	Gjinia dhe shëndeti mental në shkollë
<i>Java e dhjetë:</i>	Diversiteti dhe shëndeti mental në shkollë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Këshillimi si mekanizëm parandalimi
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Mentorimi i të rinjve si strategji parandalimi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Puna me komunitetin dhe strategjitë parandaluese
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Trajtimi i rasteve të studimit nga studentët
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përmbledhje

Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:
<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm; Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore; - Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet; - Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit; - Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;

